



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.60/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj-kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Skënder Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik Për Drenasin Kampion Ramiz Lladrovci, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më 26.09.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pa bazuar ankesa e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ZL.Anr.60/2025, e datës 24.09.2025, paraqitur kundër subjektit politik Për Drenasin Kampion Ramiz Lladrovci, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 24.09.2025, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se më datë 22.09.2025, kandidati për kryetar i subjektit politik Për Drenasin Kampion Ramiz Lladrovci, ne emisionin Debat Plus të TV Dukagjini kur është pyetur lidhur me kundër kandidatën e tij nga Lëvizja Vetëvendosje, Egzona Tërdevci ka thënë: *“Ka deklaruar që jam e gatshme me ba gjithçka për me u rritë, me u avansu. Domethënë, nuk zgjedh metoda si, veç me ece përpara”*. Tutje kanë theksuar se Egzona Tërdevci nuk ka thënë një deklaratë të tillë, për më tepër insinuata e bërë, përmban elemente të gjuhës seksiste, e cila

synon ta paraqes në publik kundër kandidaten me një imazh denigrues, duke cenuar moralin dhe integritetin e saj, duke shtuar se përbën shkelje të nenit 34 paragrafi 1 pika 11, të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme Nr.08/L-228. Në ankesë tutje theksohet se gjuha e urrejtjes ndaj grave është problem i veçantë dhe i rëndë, qe bazohet në seksizëm, gjininë dhe identitetin gjinor të tyre, ku deklarata e kandidatit Ramiz Lladrovci ndaj kandidates Egzona Tërdevci, merr formën e diskriminimit sistematik me qëllim të përjashtimit nga gara. Kanë theksuar se, praktikat diskriminuese, nxitja për dhunë dhe gjuha e urrejtjes nuk shfaqen vetëm në kuadrin e racizmit dhe ksenofobisë, por mund të marrin edhe formën e seksizmit, mizogjinisë etj.

Në ankesë theksohet se gjuha e tillë e përdorur nga kandidati Ramiz Lladrovci qartazi ka synuar poshtërimin publik të kandidates Egzona Tërdevci mbi baza gjinore.

Si prove ka bashkëngjitur video-incizim.

Në përgjigje në ankesë kanë theksuar se i kundërshtojnë në tërësi pretendimet e thëna në ankesë. Shprehja e përdorur në emisionin televiziv Debat Plus nuk ka pasur element që mund të kualifikohet si gjuhë seksiste, pasi që nuk ka pasur për qëllim të lidhet me gjininë e kandidates por më mënyrën e bërjes së fushatës, duke theksuar se qëllimi i deklaratës së përdorur ka qenë se kandidatja për kryetare të Komunës së Drenasit nga subjekti politik Egzona Tërdevci, fushatën e saj nuk e bazon në ide dhe programe por në metoda keqinformuese. Tutje në ankesë ka shtuar se është kundër çfarëdo diskriminimi të bërë në baza gjinore, duke shtuar se gjatë qeverisjes së tij e ka respektuar kuotën gjinore si në pozita udhëheqëse ashtu edhe në listën për asambleistë. Tutje ka shtuar se fakti se Egzona Tërdevci nuk zgjedhë metodë për fushatën politike e dëshmon edhe postimi i bërë ma herët duke e quajtur të njëjtin imbecil. Ka shtuar së më datë 27.12.2023, gjatë një mbledhjeje kur kuvendi ka propozuar shpalljen e qytetarëve të nderit Egzon a Tërdevci ka thënë se nuk dal në fotografi me bashkëpunëtorët e Hagës, të cilës Ramiz Lladrovci është përgjigjur *“A me qisi metoda do me më mund mua?”*, duke shtuar se në ky është deklarimi të cilin e ka cituar në emisionin Debat Plus.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik, Për Drenasin Kampion Ramiz Lladrovci, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, të LZP-së, Nr.08/L-228 me të cilën përcaktohet: *"Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërsi si në vijim: përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë"*.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik Për Drenasin Kampion Ramiz Lladrovci, Paneli i vlerësoj se janë të pabazuara dhe nuk janë bindëse, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që në intervistën e dhënë për Debat Plus, kandidati nga subjekti politik Për Drenasin Kampion Ramiz Lladrovci, drejtuar Egzona Tërdevcit se: *"Ka deklaruar që jam e gatshme me ba gjithçka për me u rritë, me u avansu. Domethënë, nuk zgjedh metoda si, veç me ece përpara"*, sipas vlerësimit të Panelit, kjo deklaratë është thjeshte një opinion ndryshe ose nje kritike por nuk paraqet gjuhë nxitëse apo gjuhe urrejtjes dhe si e tille nuk përbën shkelje të nenit 34 paragrafi 1 pika 11, të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme Nr.08/L-228. Pretendimet e parashtruesit të ankesës se kjo deklaratë përbën gjuhë seksiste dhe mizogjini, paraqet diskriminim mbi baza gjinore nuk mund të vërtetohen, dhe mbi këtë arsye, nuk ka gjetur se janë shkelur rregullat zgjedhore në dëm të ndonjë subjekti politik.

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që nga provat e ofruara të cilat parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se është kryer shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese andaj deklarami i tille nuk mund ti ipet konotacion qe nënkupton diskrimin gjinor.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi te qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nenin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 pa. 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa

ZL.Anr.60/2025 datë 26.09.2025

Kryesuese e Panelit

Kymete Kicaj



Këshillë Juridike: *Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykata Supreme të Kosovë, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.*